REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2. pika d, nenit 14 , paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 paragrafet 10.2 dhe 10.3 te Ligjit Nr.02/L-26 per Token bujqësore , nenit 8 paragrafit 8.4 dhe nenit 9 të Udhezimit administrativ Nr.41/2006 per nderrimin e tokes bujqesore si dhe nenit 20 paragrafi 20.1, dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 dt.26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur më 27. 09. 2018, pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miraton këtë :

V E N D I M
PER NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

Neni 1

I. Miratohet Vendimi për ndërrimin e destinimit te tokës bujqësore në tokë ndertimore

Neni 2

II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, toka me destinim bujqësor, parcela kadastrale P-71409001-00439-0 mwe kulturë livadh I klases së pestë ne siperfaqe prej 5010m^2, të evidentuar në certifikatën mbi të drejta e pronës së paluajtshme Nr.2276/2018 Zona Kadastrale Hanroc me te drejte posedimi individual te "Qendra per Trajtimin e Kafshëve" Sh.p.k. me numër biznesi Nr.71127168, perfaqesuar nga Lis Kabashi Drejtor- Agjent I regjistruar me seli ne Hanroc Komuna e Lipjanit, destinohet ne tokë ndërtimore.

Neni 3

Parcela kadastrale si toke bujqësore te cekura ne piken II të ketij Vendimi ne Planin Zhvillimor Komunal 15Nr.12514 dt.23.08.2013 percaktohet si tokë ndërtimore, dhe të njëjtat do te jene pjese e procesit të vlerësimit dhe hartimit të Planit zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale te Komunës.

Neni 4

Kompenzimin per ndërrimin e destinimit të tokës të cekur ne nenin 2 të këtij Vendimi do te paguhet ne procedure administrative te marrjes se lejes se ndertimit sipas dispozitave te nenit 14 paragrafi 14.2. pika a dhe b te Udhëzimit administrativ Nr.41/2006 për ndrrimin e destinimit te tokës bujqësore.

Neni 5

Obligohet investitori që implementimin e këtij Vendimi ta realizoj ne afat prej dy viteve nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij Vendimi që nënkupton zhvillimet procedurale sipas nenit 2 dhe nenit 4, në të kundërtën nese brenda afatit prej 2 viteve nuk I perfundon procedurat e parapara sipas ketij Vendimi, ky Vendim do te shfuqizohet dhe nuk do te kete fuqi juridike .

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorati per planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,Drejtorati per Gjeodezi dhe Kadastër, drejtorati për Zhvillim Ekonomik si Organet tjera të Administratës komunale do t'i kryejnë veprimet përkatëse nga përgjegjësitë e tyre me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L- 040 dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

15Nr. 320 - 61046

Lipjan, më 28. 09. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVA